

RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT
NDËRTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NË FSHATIN
GAÇKË - FAZA E DYTË



Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Ferizajt.

Organizatat e Shoqërisë Civile:
INPO, CEDF, LDA dhe Gjethi

RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT
**NDËRTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NË FSHATIN
GAÇKË - FAZA E DYTË**

Monitorues dhe Autor: Qëndrim Hoxha, Tringa Raka, Egzon Mustafa,
Arbenita Topalli dhe Valentina Abazi

Fasilitatore: Albulena Nrecaj

Ferizaj, Qershor 2019

PËRMBAJTJA

5	HYRJE
6	METODOLOGJIA
8	ANALIZA
8	I. Tejkalim i vlerës së kontratës në raport me planifikimin e prokurimit dhe kornizën buxhetore
9	II. Vonesat në vlerësimin e tendërve shkaktojnë humbje të vlerës për paranë
11	III. Çmimet e pozicioneve të punës më të shtrejta se çmimet e tregut
11	IV. Kushtet dhe menaxhimi i kontratës
13	REKOMANDIME

HYRJE

Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Ferizajt, të cilët kanë përfituar dije dhe aftësi praktike përmes punëtorive për aplikimin e mësimit mbi monitorimin e prokurimit publik, të organizuara nga Platforma CiviKos në kuadër të aktivitetit të USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese (USAID TEAM).

Pjesëmarrës të serisë së punëtorive ishin:

Arbenita Topalli – INPO

Egzon Mustafa – CEDF

Qendrim Hoxha – LDA

Tringa Raka – Gjethi

Valentina Abazi - INPO

Qëllimet e këtyre punëtorive janë: (I) aktivizimi OJQ-ve lokale për të monitoruar tenderët në nivel komunal; (II) aftësimi i OJQ-ve që të analizojnë gjetjet nga tenderët dhe të zbulojnë keqpërdorimet potenciale në prokurimin publik duke u mbështetur drejtpërdrejt nga lehtësuesit e angazhuar; dhe (III) OJQ-të të jenë të afta të përgatisin dhe publikojnë raporte mbi gjetjet e tyre gjatë monitorimit të prokurimit publik në nivel lokal.

Gjatë punëtorive Grupi Monitorues ka përzgjedhur monitorimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në fshatin Gaçkë - faza e dytë” me numër të prokurimit 656-18-1767-5-2-1, me vlerë të parashikuar të kontratës 100,000.000 €.

Të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit shpërfaqin nevojën e forcimit të sundimit të ligjit që nga faza e planifikimit të prokurimit, e deri të nënshkrimi i kontratës, si dhe ngritjen e përgjegjshmërisë së zyrtarëve publik të cilët janë të përfshirë direkt apo indirekt në iniciimin dhe zbatimin e prokurimit.

METODOLOGJIA

Grupi Monitorues ka përdorur një metodologji të kombinuar për monitorimin e aktivitetit të prokurimit. Fillimisht Grupi Monitorues përzgjedhjen e tenderit për monitorim e ka bërë duke u bazuar në indikatorë automatik të përzgjedhjes siç është: “çmimi i ofertës fituese më i lartë se vlera e parashikuar e kontratës” dhe “rëndësisë që ka projekti për komunitetin”. Gjatë fazës së monitorimit është bërë analiza cilësore e dokumenteve relevantë që përmbajnë të dhëna primare zyrtare të aktivitetit të prokurimit, intervista me zyrtarin përgjegjës të prokurimit, si dhe monitorimi i vend-punishtes (vendit në të cilin zbatohet projekti / kontrata).

Grupi Monitorues ka vlerësuar zbatimin e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke u bazuar në një indikator kyç, ku janë shqyrtuar dhe analizuar gjashtëmbëdhjetë (16) dokumente.

Indikator: Aktiviteti i prokurimit përfshinë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RRUOP).

Vlerësimi i aktivitetit përmes këtij indikator është bërë duke analizuar përmbajtjen e dokumenteve, si në vijim:

- Planifikimi përfundimtar i prokurimit;
- Kërkesa për inicimin e aktivitetit të prokurimit nga njësia kërkuese;
- Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve (B04);
- Njoftimi për kontratë (B05);
- Dosja e tenderit (B17);
- Paramasa dhe parallogaria;
- Regjistri i operatorëve ekonomik (OE) që e kanë pranuar dosjen e tenderit (B13);
- Regjistri i tenderëve të dorëzuar;
- Vendimi i formimit të Komisionit për hapje;
- Procesverbali i hapjes së tenderit (B12);
- Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësimin e tenderëve;
- Raporti i Vlerësimin të tenderëve (B36);
- Njoftimi për dhënie të kontratës (B08);

-
- Kontrata;
 - Vendimi për caktimin e menaxherit/es së projektit;
 - Plani për Menaxhimin e Kontratës.

Të gjitha këto dokumente Grupi Monitorues i ka siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, dhe platformën elektronike për prokurim publik. Grupi Monitorues është takuar pesë herë në zyret e OJQ INPO në datat:

- Dita I-rë 06.09.2018;
- Dita II-të-20.09.2018;
- Dita III-të 05.10.2018;
- Dita IV-të-10.10.2018; dhe
- Dita V-të 20.10.2018.

Grupi Monitorues me lehtësimin e Albulena Nrecaj, kanë shkarkuar të gjitha dokumentet nga platforma elektronike e prokurimit, dhe se bashku kanë analizuar të gjitha dokumentet. Po ashtu Grupi Monitorues ka realizuar edhe vizitë në vend-punishte. Pas analizimit të gjitha dokumenteve, raporti i të gjeturave është dërguar tek Komuna e Ferizajt për komente, dhe pas këtij procesi është finalizuar raporti.

Në këtë raport nuk përfshihet analiza e zbatimit të kontratës pasi që kontrata ka nisur zbatimin në muajin shtator 2018, dhe pritet që të zbatohet brenda dy (2) viteve (2018-2019).

ANALIZA

I. TEJKALIM I VLERËS SË KONTRATËS NË RAPORT ME PLANIFIKIMIN E PROKURIMIT DHE KORNIZËN BUXHETORE

Komuna e Ferizajt në muajin gusht ka lidhur kontratë për ndërtimin e sallës së edukatës fizike në shkollën fillore të fshatit Gaçkë, me konzorciumin “G&A Consulting” dhe “Pro&Co Group” në vlerë prej 117,209.95 €, përmes procedurës së hapur.

Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Komuna ka lidhur kontratë trefish më të lartë se vlera e parashikuar në planifikimin përfundimtar të prokurimit, në të cilën vlera e parashikuar e kontratës ishte 40 mijë €.¹
- Mospërputhje është gjetur edhe në mes të kornizës buxhetore të komunës për vitin 2018-2021 dhe planit përfundimtar të prokurimit.

Në kornizën buxhetore për projekte kapitale 2018-2020, komuna ka paraparë 90 mijë € për ndërtimin e sallës së edukatës fizike, respektivisht 40 mijë € në vitin 2018 dhe 50 mijë € në vitin 2019², e cila shumë nuk është reflektuar në planifikimin përfundimtarë të prokurimit. Kështu, komuna ka dështuar të bëjë planifikimin e prokurimit në pajtim me buxhetin.

Në anën tjetër, në njoftimin për kontratë vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 100 mijë €³, ndërkaq çmimi i ofertës fituese është 117 mijë e 209.95 €. Kështu, Komuna e Ferizajt ka lidhur kontratë mbi 17 mijë € më të shtrenjtë se vlera e parashikuar me njoftimin për kontratë, ndërsa diferenca me buxhetin e Komunës për këtë projekt është 27 mijë €.

Planifikimi i Prokurimit	Buxheti 2018 - 2020	Njoftimi për kontratë	Kontrata
40 000 €	90 000 €	100 000 €	117 209.95 €

Figura 1. Diskrepanca në mes të dokumenteve të planifikimit më çmimin e kontratës.

¹ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit për vitin fiskal 2018, Komuna e Ferizajt, i qasshëm në: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/prokurimi/plani-i-prokurimit/>

² Buxheti 2018-2020, Komuna e Ferizajt, i qasshëm në: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/ep-content/uploads/sites/31/2018/03/BUXHETI-2018-FINAL.pdf>

³ Njoftim për kontratë, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=125828

Hyrja në marrëdhënie kontraktuale në shuma më të larta se disponueshmëria e mjeteve financiare të komunës është e ndaluar sipas nenit 9 të Ligjit për Prokurimin Publik⁴ dhe Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë të Republikës së Kosovës. Megjithatë, Komuna është dashur që të siguroj mjete shtesë në mënyrë që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit. Mirëpo, Grupi Monitorues në regjistrin e prokurimit të kësaj lënde, nuk ka gjetur asnjë dokument që dëshmon sigurimin e mjeteve shtesë për këtë kontratë.

Rrjedhimisht, kontraktimi i projekteve në vlera shumë me të larta në raport me kornizën buxhetore të investimeve kapitale, respektivisht mjeteve financiare në dispozicion rritë rrezikun për rritjen e obligimeve kontraktuale të cilat më pas mund të shkaktojnë vështirësi financiare për Komunën. Po ashtu rrit rrezikun e pagesave përmes përmbarimit, të cilat më pas do të afektonin dhe cenonin financimin e projekteve të tjera si rezultat i përmbarimit.

Grupi Monitorues, ka gjetur se Zyrtaari Përgjegjës i Prokurimit, Zyrtaari Kryesor Financiar, dhe Kryetari i Komunës, para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, nuk e kanë konfirmuar se informatat financiare janë të sakta dhe nuk kanë ndryshuar materialisht, ashtu sikur kërkohet në nenin 9 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në formularin B04 Deklarata e Nevojave dhe Disponueshmërisë se Fondeve, e datës 20.03.2018 nuk figurojnë nënshkrimet e këtyre 3 zyrtarëve. Po ashtu, në regjistrin e prokurimit nuk është gjetur urdhëresa e zotimit dhe e pagesës me ç'rast nuk kemi arritur të identifikojmë se sa mjete realisht i ka zotuar Komuna, kur ka iniciuar aktivitetin e prokurimit.

II. VONESAT NË VLERËSIMIN E TENDERËVE SHKAKTOJNË HUMBJE TË VLERËS PËR PARANË

Komuna për shkak të vonesave në vlerësimin e tenderëve dhe skadimit të validitetit të ofertave, ka humbur mundësinë që të lidhë kontratë me operatorin ekonomik, i cili ka ofruar çmimin më të lirë për kontratë, dhe i cili ka qenë i përgjegjshëm dhe i përshtatshëm sipas ligjit dhe rregullave. Rrjedhimisht, Komuna ka lidhur kontratë për 28% më të shtrenjtë, si pasojë e vonesave në vlerësim.

Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Dorëzimi dhe hapja e tenderëve ishte bërë më 11.04.2018.⁵ Për këtë kontratë kishin ofertuar gjashtë operatorë ekonomik.

⁴ Shënim: Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

⁵ Njoftim për Kontratë, i qashëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=327>

Tenderuesi	Çmimi me TVSH €
ARDRITI N.N.P dhe ATC COM Sh.PK	122,777.13 €
G&A CONSULTING dhe PRO&CO	117,849.95 €
€ \$ COMERCE	117,500.00 €
AGONI	117,524.50 €
OLTAND GROUP	84,720.40 €
ART PORJECT	154,797.91 €

- Formimi i Komisionit për Vlerësimin e Tenderëve ishte bërë më 18.04.2018.⁶ Sipas këtij vendimi komisioni ka qenë i obliguar që të filloj punën në po atë ditë kur është marrë vendimi.
- Komisionit për vlerësim iu ish in dashur 63 ditë kohë për të bërë vlerësimin e 6 ofertave⁷, sa ish in gjithsej të dorëzuara për këtë aktivitet të prokurimit. Zvarritja e vlerësimit të tenderit është shkelje e nenit 41.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurimit Publik, i cili obligon autoritetet kontraktuese që procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve të kryhet brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

Për shkak të vonesave në vlerësimin e tenderëve, validiteti i tenderit kishte skaduar. Sipas dosjes së tenderit, vlefshmëria e sigurisë së tenderit ishte 60 ditë⁸. Dy (2) ditë para publikimit të njoftimit për vendimin e Autoritetit Kontraktues për ofertën fituese, Autoriteti kontraktues kishte publikuar kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës edhe për 30 ditë të tjera.⁹ Mirëpo, operatorët ekonomik në garë për këtë tender, sipas kësaj kërkesë kishin vetëm 24 orë kohë, që përmes e-mailit ta konfirmonin vlefshmërinë e tenderit. Për çdo ndryshim a kërkesë shtesë rregullat kërkojnë që së paku 48 orë tu lihet në dispozicion OE që të veprojnë.

Kësisoj, sipas raportit për vlerësimin e tenderëve dy (2) nga gjashtë (6) operatorët ekonomik, nuk e kishin vazhduar validitetin e ofertës.¹⁰ Njëra nga këto dy (2) oferta të cilës i kishte skaduar validiteti ishte edhe oferta më e lirë në vlerë prej 84,720.10 €, pra për 32,489.85 € më e lirë se oferta fituese.

Mirëpo, operatori ekonomik që kishte ofruar ofertën më të lirë, nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës pasi që e kishte humbur interesimin për këtë tender për shkak të vonesave në vlerësim. Grupi Monitorues përmes telefonit ka kontaktuar operatorin ekonomik¹¹ për të pyetur rreth arsyeve që kanë ndikuar në mos-vazhdimin e validitetit të tenderit, dhe operatori ekonomik është shprehur se nuk kanë pasur më interesim,

⁶ Vendim Nr. 01-45 A/2018, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave, i datës 18.04.2018.

⁷ Shënim: Sipas procesverbalit të hapjes së tenderit, i datës 11.04.2018, 6 operatorë ekonomik kanë dorëzuar ofertë për tenderin “Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në fsh.Gaçkë - Faza e dytë”.

⁸ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=327>

⁹ Kërkesë për vazhdimin e validitetit të tenderit, i qashëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=327>

¹⁰ Raporti i vlerësimit të tenderëve, i datës 29.06.2018, Komuna e Ferizajt.

¹¹ Intervistë me përfaqësuesin e “OLTAND GRUP” sh.p.k, Afrim Kolgeci, më 10.10.2018

për shkak se Komuna është vonuar në procesin e vlerësimit, dhe gjatë asaj periudhe kohore operatori ekonomik kishte kontraktuar punë të tjera, dhe nuk ka pasur interesim që të hynte në marrëdhënie kontraktuale edhe me Komunën e Ferizajt. Po ashtu, ai ka thënë për Grupin Monitorues se disa nga pozicionet e projektit kanë pasur probleme dhe nuk kanë qenë të detajuara mirë nga ana e Komunës, dhe kësaj do të na dilnin probleme gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim nga ana e operatorëve ekonomik, rrjedhimisht asnjë ankesë në OSHP.

III. ÇMIMET E POZICIONEVE TË PUNËS MË TË SHTRAJTA SE ÇMIMET E TREGUT

Gjatë analizës së kontratës dhe paramasës, Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Në pozicionin D - *Punët e Armimit*, kërkohet furnizimi, montimi i armaturës me profile të ndryshme me sasi prej 14 mijë e 980 kg. Mirëpo, në këtë pozicion Komuna nuk e kishte saktësuar profilin e nevojshëm të armaturës ashtu sikur kërkohet më rregullat e ndërtimit dhe prokurimit. Për këtë pozicion operatori fitues ka ofruar çmimin prej 0.69 € për kilogram, respektivisht për gjithë pozicionin, total 10 mijë e 336.20 €.

Sipas çmimeve të tregut, një kilogram armaturë kushton rreth 0.65 €. Po ashtu, kompanitë¹² që bëjnë furnizimin më armaturë në kushte anonimiteti kanë thënë për Grupin Monitorues se në vitet e fundit çmimi i armaturës asnjëherë nuk ka qenë 0.69 € për kg. Rrjedhimisht, komuna ka kontraktuar punë që në pozicione të caktuara çmimet janë më të larta se çmimet e tregut.

Përveç kësaj, dobësi tjetër është se mospërcaktimi i një specifike të tillë mund të ndikojë në kualitetin e ndërtimit të vrazhdë, si dhe në vendosjen e armaturës së papërshtatshme në objekt, kështu duke e vështirësuar edhe punën e mbikëqyrësit të punimeve pasi që është e vështirë të bëhet vlerësimi nëse armatura është adekuatë sepse mungojnë përshkrimet.

IV. KUSHTET DHE MENAXHIMI I KONTRATËS

Pas analizës së kontratës Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Brenda kushteve dhe përmbajtjes së kontratës nuk është specifikuar kohëzgjatja dhe afati i përfundimit të kontratës. Sipas nenit 10.2 të pjesës së III-të të kontratës “Kushtet e Veçanta” përfundimi i punëve është parashikuar të bëhet brenda 90 ditëve, mirëpo, nuk është specifikuar nëse kontrata është kontratë dy

¹² Shënim: Kompanitë e intervistuarat kanë kërkuar që identiteti i tyre të mbetet anonim.

(2) vjeçare, ashtu sikur ishte paraparë gjatë inicimit të aktivitetit të prokurimit.¹³

- Tutje, siguria e ekzekutimit të kontratës në vlerë prej 10%, sipas kontratës është valide deri më 30.12.2018.¹⁴ Sipas rregullave të prokurimit vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të kontratës duhet të jetë prej 30 ditëve pas kompletimit të kontratës.¹⁵ Nëse i referohemi kësaj rregulle, kontrata është dashur të zbatohet deri më 30 nëntor 2018. Mirëpo, ashtu sikur është shpjeguar në Kapitullin I-rë të këtij raporti, financimi i këtij projekti, respektivisht kontratës, sipas buxhetit të Komunës, është paraparë të bëhet brenda dy (2) viteve fiskale, 2018-2019. Grupi Monitorues ka vizituar vend-punishten, dhe projekti është akoma në fazë të hershme të realizimit dhe përfundimi i punëve nuk pritet të bëhet brenda këtij viti.

Tutje, Komuna nuk ka *Plan për Menaxhimin e Kontratës*. Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Në Regjistrin e prokurimit, nuk ka qenë i administruar Plani i Menaxhimit të Kontratës, ndërkaq, zyrtari përgjegjës i prokurimit është arsyetuar se këtë plan e posedon Menaxheri i Kontratës. Menaxheri i kontratës ka refuzuar që t'i ofroj qasje pjesëmarrësve në këtë plan, me arsyetimin se të njëjtin duhet ta kërkojmë në zyrën e prokurimit.

Pavarësisht mos-gatishmërisë së menaxherit të kontratës për të ofruar qasje, në bazë të rregullave të prokurimit, menaxheri është i obliguar që kopjen e planit për menaxhimin e kontratës të ja përcjellë zyrtarit përgjegjës të prokurimit, i cili kopjen e këtij dokumenti e vendos në kontratë duke e shndërruar, në pjesë përbërëse të kontratës.¹⁶

Kjo rregull është vendos në bazë të nenit 81, Ligji për Prokurimin Publik, i cili e obligon komunën që për kontrata të vlerës së madhe dhe të mesme, pas nënshkrimit të kontratës, të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave duke përfshirë në bazë të rrethanave: (I) ekipet e menaxhimit të projekteve; (II) rishikime të shpeshta të kontratës; (III) protokollet për dorëzimin e pajisjeve të autorizuara; (IV) dialogun e rregullt me kontraktuesit; (V) përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë; (VI) menaxhimit të pagesave / kërkesave; (VII) procedurat e ankesave; (VIII) mjetet e kontrollit të specifikuar në kontratë, dhe (IX) sigurimi i ekzekutimit mbahet për defekte / korrigjim dhe përcaktimin e procedurave për këto në vijim sa herë që është e nevojshme: (I) inspektimin e vendit të punimeve, materialeve dhe të objekteve të prodhimit; (II) sigurimin e dorëzimit efektiv, ruajtjen dhe sigurinë e artikujve të përfshira në kontratë; (III) caktimi i afatit të dorëzimit; (IV) variacionet / ndryshimet.

¹³ Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve (B04), e nënshkruar më 20.03.2018.

¹⁴ Kontrata “Ndërtimi i Salles së Edukates Fizike në fshatin Gaçke-faza e dytë”, e qasshme në: <https://kk.rks.gov.net/ferizaj/ep-content/uploads/sites/31/2018/08/52-Ndertimi-i-Salles-se-edukates-fizike-ne-fsh-Ga%C3%83%C2%A7ke.pdf>

¹⁵ Rregullat dhe Udhëzuesi për Prokurim Publik, neni 30.6, i qasshëm në: <https://krpp.rks.gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rruopp13042018.pdf>

¹⁶ Rregullat dhe Udhëzuesi për Prokurim Publik, neni 61.9 dhe 61.11, i qasshëm në: <https://krpp.rks.gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rruopp13042018.pdf>

Mirëpo, në regjistrin e prokurimit nuk është gjetur një plan i tillë. Vetëm caktimi i menaxherit të projektit është bërë me kohë dhe sipas ligjit. Rrjedhimisht, mos qartësimi i kushteve të kontratës dhe mungesa e planit për menaxhimin e kontratës rrisin rrezikun e zvarritjes së zbatimit të kontratës, kontroll dhe mbikëqyrje jo efektive, dhe përbën potencial të mjaftueshëm për mos realizimin e kontratës në mënyrë cilësore çka i pamundëson komunës arritjen e objektivave të saj dhe qëllimit të realizimit të prokurimit.

Të gjeturat e këtij hulumtimi paraqesin nevojën imediate për të intervenuar në adresimin e problemeve dhe shkeljeve ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.

REKOMANDIME

Në këtë drejtim Grupi Monitorues rekomandon që:

1. Kryetari i komunës dhe Udhëheqësi i Prokurimit duhet të sigurohen që vlera e parashikuar e projekteve në buxhetin e Komunës të jetë e njëjtë edhe në planin e prokurimit.
2. Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që secila njësi e kërkesës brenda komunës të bëjë parashikime të përafërta të kostove të projektit, në mënyrë që të shmanget suficiti i buxhetit apo nevoja për të marrë mjete nga linjat tjera buxhetore.
3. Meqë vonesat në vlerësim të ofertave ka rezultuar me tërheqje të një kompanie dhe rrjedhimisht rritje të kostos së projektit për 30%, Kryetari i Komunës duhet të kërkojë llogari nga anëtarët e komisionit për vonesat në vlerësim.
4. Kryetari i komunës duhet të sigurojë që secili komision vlerësues të nis vlerësimin e ofertave menjëherë pas formimit për të parandaluar rastet kur një OE që ka dorëzuar ofertë të ultë të tërhiqet pa u penalizuar apo të ketë 'pazare' në mes të bizneseve për kurdisje të fituesit.
5. Komuna duhet të hartoj më saktësi kushtet e kontratës në mënyrë që t'i shmanget pasojave dhe rrezikut në mos përmbushjen e saj.
6. Kryetari i Komunës duhet t'ia kërkojë menaxherit të Kontratës planin e menaxhimit të kontratës, dhe njëkohësisht të mbajë përgjegjësinë edhe zyrtarin përgjegjës të prokurimit.

